



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.59/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e Pashije Isufi e lindur në Zhujë, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar apeli Anr.59/2019. i datës 20.09.2019, parashtruar nga Pashije Isufi e lindur në Zhujë me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Pashije Isufi, në të cilën parashtruesja e apelit pretendon se me datën 09.09.2019 kam dorëzuar aplikimin për regjistrim për votim jashtë vendit, aplikimit ja kam bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar (formularin e plotësuar dhe dokumentin e identifikimit), nga KQZ-ja kam marr konfirmimin për pranimin e aplikimit, por emri im nuk gjendet ne listën përfundimtare te votuesve jashtë vendit te shpallur nga KQZ-ja. Parashtruesja me tutje shton se kërkoj qe ankesa te me shqyrtohet dhe emri im te futet ne liste, kështu te me mundësohet shfrytëzimi i te drejtës kushtetuese te votimit. Parashtruesja e apelit si dëshmi për pretendimet e saj e ka bashkangjitur pasaportën si mjet identifikimi.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Pashije Isufi, është e palejuar pasi që nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas Rregullës Nr.02/2015 të

nenit 10.6 dhe 10.7 ku përcaktohet se: *Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e lartë theksuara.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 59/2019 më datën 20.09.2019.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*